



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.575/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.09.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Shehu” sh.p.k, në procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime” me Nr.REF-65953-04-29-2018 me objekt “Rehabilitimi i Kanalit Ujitës Debrovë, Peshkopi 2018”, me fond limit 2,500,000 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 11.05.2018 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dibër.

Ankimues:

“Radika” shpk
Lagjia “Gjok Doçi”, Peshkopi

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Dibër
Bulevardi “Elez Isufi”

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjo relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 29.04.2018 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit *Kërkesë për Propozime* me Nr.REF-65953-04-29-2018 me objekt “*Rehabilitimi i Kanalit Ujitës Debrovë, Peshkopi 2018*”, me fond limit 2,500,000 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 11.05.2018 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dibër.

II.2. Në datën 11.05.2018 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 16.05.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

- Arben Lleshi	pa ofertë	I skualifikuar
- Xhani	1,423,000	I skualifikuar
- Shehu	2,027,672	I kualifikuar

- Doda Ndërtim	2,039,674	I skualifikuar
- 2N	2,290,374	I skualifikuar
- Radika	2,426,917	I kualifikuar

II.4. Në datën 22.05.2018, operatori ekonomik ankimues “Radika” shpk ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- *Operatori ekonomik Shehu shpk nuk plotëson kriteret si më poshtë:
2.2.2 Kopje te certifikuara te bilanceve te tre viteve te fundit ushtrimore te paraqitur nga Autoriteti Perkates dega e Tatim Taksave,te konfirmuar nga Autoriteti si dhe te shoqeruar me akt ekspertize e ekspertit kontabel te autorizuar. OE Shehu nuk ka dorëzuar bilance të konfirmuara nga autoritetet përkatëse dhe nuk janë të shoqëruara me akt ekspertizën e ekspertit kontabël.*
- *Pikën 2.3 Për kapacitetin teknik: Persa I perket aftesise teknike e profesionale,Operatori Ekonomik duhet te permbushë kerkesat minimale te cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si me poshte: Pervoje e suksesshme ne realizimin e te pakten: Pune te ngjashme per nje objekt te vetem me vlere 50 % e vleres se perlllogaritur te kontrates qe prokurohet leke pa T.V.SH, te realizuar gjate tre viteve te fundit ose Kontrata te ngjashme ku vlera monetare totale e puneve te kryera e marre se bashku gjate tre viteve te fundit eshte ne nje vlere sa dyfishi I vleres limit te kontrates qe prokurohet. OE Shehu nuk e plotëson këtë kriter pasi asnjë nga kontratat e dorëzuara nuk është kontratë e ngjashme me objektin që prokurohet.*
- *Pika 4 Operatori duhet te kete ne listapagese stafin teknik te meposhtem (Kontrate Pune dhe CV): Nga te cilet drejtues teknik -Inxhinier ndertimi minimumi 1 (nje); -Inxhinier gjeodet/topograf minimumi 1 (nje); Inxhinier hidroteknik / minimumi (nje). OE Shehu nuk ka dorëzuar dokument (kontratë pune dhe CV) që vërteton se ka në listpagesa stafin drejtues teknik Inxhinier Gjeodet /topograf.*
- *Pika 5 Operatori ekonomik duhet te kete te siguruar ne listepagesa per periudhen Janar 2018 – Prill 2018 Inxhinier hidroteknik (nje) (per inxhinierin te paraqitet diploma dhe CV); Murator (nje) (per muratorin te paraqitet deshmia e kualifikimit profesional te leshuar nga institucionet perkatese) ; Teknik Ndertimi (nje) (per teknikun e ndertimit te paraqitet deshmia e kualifikimit profesional). OE Shehu nuk vërteton se ka në listpagesa për periudhën Janar 2018-prill 2018 punonjës me profesion Murator pasi nuk ka paraqitur asnjë punonjës me dëshmi kualifikimi profesional.*

OE Shehu nuk vërteton se ka në listpagesa për periudhën Janar 2018-Prill 2018 punonjës me profesion Teknik Ndërtimi . Tekniku i paraqitur nga Shehu është teknik arkitekt dhe nuk

ka njehsuar diplomën pasi nuk është pajisur me këtë diplomë në RSH. Sipas Legjislacionit të Ministrisë së Arsimit duhet të bëhet njehsimi i diplomave të huaja.

- Pika 8. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund të vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojitet për ekzekutimin e kontratës.

Nr	LLOJI I MAKINERIVE	PRONESIA	SASIA Minimumi
1.	<i>Kamiona me ngarkese mbajtëse mbi 8 ton</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>2 cope</i>
2.	<i>Betoniere 0.5 m3</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>2cope</i>
3.	<i>Minieskavator</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>1 cope</i>
4.	<i>Kamioncine</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>1 cope</i>
5.	<i>Karroca dore</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>5 cope</i>
6.	<i>Vibrator thellesie</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>1 cope</i>
7.	<i>Depozite uji 5000l</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>1 cope</i>
8.	<i>Kokore pune</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>10 cope</i>
9.	<i>Fikse zjarri</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>2cope</i>
10.	<i>Komplet I ndihmes se shpejte</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>3cope</i>
11.	<i>Tabela paralajmeruese</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>2 cope</i>
12.	<i>Eskavator me goma</i>	<i>Ne pronesi ose me qera</i>	<i>1 cope</i>

OE ka plotësuar pjesërisht këtë kriter pasi nuk ka vërtetuar se disponon makineri (kamion) sipas specifikimeve teknike me kapacitet mbi 8 ton sasia 2 copë. Gjithashtu nuk ka vërtetuar se disponon minieskavator.

Sa më sipër kërkojmë skualifikimin e shoqërisë Shehu shpk.

II.5. Në datën 28.05.2018 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.2254/1 prot i kthen përgjigje palës ankimese duke vendosur mospranimin e ankesës.

II.6. Në datën 06.06.2018 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.7. Njëpërmjet shkresës nr.2607/1 prot., datë 17.06.2018 protokolluar me tonën me nr.1069/2 datë 19.06.2018 me objekt “Dërgohet informacion”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Radika” shpk mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Shehu” shpk me argumentat se “*Operatori ekonomik Shehu shpk nuk plotëson kriteret si më poshtë: 2.2.2 Kopje te certifikuara te bilanceve te tre viteve te fundit ushtrimore te paraqitur nga Autoriteti Perkates dega e Tatim Taksave,te konfirmuar nga Autoriteti si dhe te shoqeruar me akt ekspertize e ekspertit kontabel te autorizuar. OE Shehu nuk ka dorëzuar bilance të konfirmuara nga autoritetet përkatëse dhe nuk janë të shoqëruara me akt ekspertizën e ekspertit kontabël*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 11 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.2. “Për kapacitetin ekonomik dhe financiar”, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

- 2.2.2 Kopje te certifikuara te bilanceve te tre viteve te fundit ushtrimore te paraqitur nga Autoriteti Perkates dega e Tatim Taksave,te konfirmuar nga Autoriteti si dhe te shoqeruar me akt ekspertize e ekspertit kontabel te autorizuar.

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se operatori ekonomik “Shehu” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Pasqyrat Financiare për Vitin 2015 të konfirmuara nga organet tatimore
- Pasqyrat Financiare për Vitin 2016 të konfirmuara nga organet tatimore
- Pasqyrat Financiare për Vitin 2017 të konfirmuara nga oraganet tatimore

III.1.3. Në ligjin 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” neni 41 të ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare

Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese:

a) të gjitha shoqëritë tregtare, pavarësisht nga forma e tyre, të cilat zbatojnë standardet ndërkombëtare të raportimit financiar;

b) të gjitha shoqëritë aksionare, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit;

c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;

ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;

iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël.”

III.1.4. Në nenin 46, pika 1 gërma “c” e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “ [...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: c) gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur.

III.1.5. Neni 53 pika 3 e Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji*

III.1.6. Sa më sipër Komisioni konstaton se në kriterin e vecantë të kualifikimit autoriteti akontraktor ka kërkuar nga operatorët ekonomikë pjesmarrës të paraqesin bilancet e viteve 2015, 2016, 2017 të konfirmuara nga autoritetet perkatëse (organi tatimor) dhe të shoqeruar me *akt ekspertize e ekspertit kontabel të autorizuar*. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik Shehu shpk, Komisioni konstaton se janë dorëzuar pasqyrat financiare për vitet 2015, 2016, 2017 të certifikuara nga organet tatimore, të pashoqëruara me *akt ekspertize e ekspertit kontabel të autorizuar*.

III.1.7. Referuar bazës ligjore të sipërcituar KPP morri në shqyrtim dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik Shehu dhe verifikimin nëse ky operator përmbush dy nga kushtet kumulative të parashikuara në ligjin e sipërcituar për auditimin e pasqyrave financiare. KPP referuar pasqyrave financiare të dorëzuara nga operatori “Shehu” shpk konstaton se totali i aktiveve për vitin 2015 rezulton në shumën 56,984,127, për vitin 2016 në vlerën 50,942,820 dhe për vitin 2016 në vlerën 52,484,055.

Akoma më tej, Komisioni pas shqyrtimit në tërësi të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik Shehu lidhur me plotësimin e kushteve kumulative që ligji parashikon për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, konstaton se shoqëria “Shehu” shpk, referuar vërtetimit Nr.T00276755 datë 02.05.2018 të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Dibër ka raportuar të ardhura nga shitja e mallrave/ shërbimeve, si më poshtë: për vitin 2015, shumën prej 21,701,991 lekë; për vitin 2016, shumën prej 15,466,322 lekë; për vitin 2017 shumën prej 28,067,160 lekë.

Gjithashtu referuar sërish pasqyrave financiare, rezulton se shoqëria “Shehu” shpk, ka pasur fuqi mesatare të punonjësve prej 10 punonjësish për vitin 2015 dhe 2016 dhe një numër mesatar prej 17 punonjësish për vitin 2017.

Sa më sipër KPP gjykon se operatori ekonomik Shehu shpk nuk plotëson dy nga treguesit e vendosur nga legjislacioni në fuqi, për kryerjen e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore për vitet 2015,2016,2017, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Radika” shpk nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Radika” shpk për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Shehu” shpk me argumentat se “ *Në pikën 2.3 Për kapacitetin teknik: Persa i perket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë: Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën: Pune të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet leke pa T.V.SH, të realizuar gjatë tre viteve të fundit ose Kontrata të ngjashme ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marre së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. OE Shehu nuk e plotëson këtë kriter pasi asnjë nga kontratat e dorëzuara nuk është kontratë e ngjashme me objektin që prokurohet.*”

III.2.1. Në shtojcën 11 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3. “Për kapacitetin teknik”, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

1. *Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:*

a. *Pune të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet leke pa T.V.SH, të realizuar gjatë tre viteve të fundit;*
ose

b. *Kontrata të ngjashme ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marre së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.*

Plotësimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën e kualifikueshme.

Vleresimi i pervojes se sukseshme te Operatorit Ekonomik do te kryhet bazuar ne deklaratat e dokumentat e meposhtme:

- *Kontrata*
- *Situacioni perfundimtare*
- *Aktin e kolaudimit*
- *Fature tatimore*
- *Formular Vleresimi*

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se operatori ekonomik “Shehu” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë.

- Kontratë Nr.16/9 prot datë 22.10.2013 me objekt “*Mirëmbajtje rutine e dimërore rruga Ura e Cerenezit Stebleve 39 km*”, lidhur ndërmjet Drrjtoria e Rajonit Verior Shkodër dhe Bashkimit të operatorëve ekonomikë Shehu shpk&Selami shpk me vlerë totale të kontratës 27,941,000 lekë pa tvsh shoqëruar me Procesverbal Certifikim Mujor Punimesh -23.09.2015-22.10.2015, certifikim përfundimtar punimesh 23.10.2013-22.10.2015, Situacion përfundimtar punimesh, Formular Vlerësimi
- Kontratë Nr.2587 prot datë 02.11.2015 lidhur ndërmjet ZVRPP Dibër dhe Shehu shpk me objekt “*Rikonstruksion i ZVRPP Dibër*” me vlerë totale të kontratës 1,089,100 lekë pa tvsh,, shoqëruar me situacionin përfundimtar, Akt marrje përfundimtare në dorëzim e objektit, Akt Kolaudimi, datë 22.11.2015, Formular Vlerësimi.
- Kontratë Sipërmarrje me objekt “*Rikonstruksion i ambjenteve të shtëpisë së banimit në pronësi të qytetarit Halit Leci, Arjana Veshi e Fiqirie Lila, bashkia Bulqizë dhe Qytetares Zelie Gjoni Maqellarë Bashkia Dibër*” me vlerë totale të kontratës 2,687,155 lekë me tvsh , shoqëruar me Formular Vlerësimi, Situacion Përfundimtar dhe Fatura Tatimore Shitje.
- Kontratë Shërbimi Nr.1337/1 prot datë 10.12.2015 lidhur ndërmjet Bashkia Dibër dhe Shehu shpk me objekt “*Mbrojtje Brigjesh të fshatit Potgorc Lumi Drini i Zi*”, shoqëruar me Situacion Përfundimtar, Akt marrje përfundimtare në dorëzim e objektit, me vlerë totale të kontratës 1,006,362 lekë me tvsh.
- Kontratë nr.45/10 datë 04.09.2017 me objekt “*Rehabilitim i varrezave të dëshmorëve Dibër 2017-2018*” lidhur ndërmjet Bashkia Dibër dhe operatorit ekonomik Shehu shpk me vlerë të kontratës 4,129,952 lekë me tvsh, shoqëruar me preventiv, Stucion Përfundimtar, Akt Kolaudimi, Akt Marrje ne Dorëzim, Formular Vlerësimi.

III.2.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “c” e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “ [...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: c) gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur

kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur.

III.2.4. Neni 53 pika 3 e Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji*

III.2.5. Neni 26 i VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” , i ndryshuar parashikon shprehimisht se:

- *Për të provuar përvojën mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:*
- *a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.*
- *b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.*
- *Autoriteti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë dhe çdolloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshmetë punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti kontraktor kërkon si dëshmi vërtetime ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdolloj dokumenti tjetër, që parashikohet në legjislacionin në fuqi, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.*

III.2.6. Referuar sa më sipër KPP pasi morri në shqyrtim dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik “Shehu” shpk si dhe pasi e krahasoi atë me zërat e punimeve të publikuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi konstaton se në situacionet e kontratave rezultojnë zëra të ngjashëm punimesh. KPP gjykon se në asnjë rast nuk mund të pretendohen zëra të ngjashëm për të gjithë zërat e preventivit, pasi një gjë e tillë të çon drejt përcaktimit të zërave të njëjtë të punëve, në kundërshtim kjo me rregullat e prokurimit publik si më sipër cituar. Një përcaktim i tillë që në vetvete nënkupton eksperiencën të njëjta apo zëra të njëjtë të shërbimeve/punëve publike apo mallrave, bie në kundërshtim edhe me vetë frymën dhe qëllimin e ligjit të përcaktuara në nenin 1 të tij, duke frenuar konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomik dhe duke bërë një trajtim jo të barabartë dhe diskriminues të këtyre operatorëve ekonomik pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik.

Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, operatori ekonomik Shehu shpk e ka përmbushur kriterin e kualifikimit duke vërtetuar kështu se disponon kapacitetet në lidhje me eksperiencat e mëparshme të kërkuara nga autoriteti kontraktor për të realizuar këtë kontratë.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “Radika” shpk nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimeus “Radika” shpk për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Shehu” shpk me argumentat se “*Pika 4 Operatori duhet te kete ne listapagese stafin teknik te meposhtem (Kontrate Pune dhe CV): Nga te cilet drejtues teknik -Inxhinier ndertimi minimumi 1 (nje); -Inxhinier gjeodet/topograf minimumi 1 (nje); Inxhinier hidroteknik / minimumi (nje). OE Shehu nuk ka dorëzuar dokument (kontratë pune dhe CV) që vërteton se ka në listpagesa stafin drejtues teknik Inxhinier Gjeodet /topograf.*”

III.3.1. Në shtojcën 11 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3. “*Për kapacitetin teknik*”, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

4.Operatori duhet te kete ne listapagese stafin teknik te meposhtem (Kontrate Pune dhe CV):

Nga te cilet drejtues teknik

- 1. Inxhinier ndertimi minimumi 1 (nje)*
- 2. Inxhinier gjeodet/topograf minimumi 1 (nje)*
- 3. Inxhinier hidroteknik / minimumi (nje)*

III.3.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se operatori ekonomik “Shehu” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë.

- *Licencë e Shoqërisë Shehu në të cilin figuron si Drejtues Teknik Erin Dedja*
- *Kontratë Individuale Pune lidhur ndërmjet Shoqërisë Shehu në cilësinë e punëdhësit dhe Erin dedja në cilësinë e punëmarrësit me profesion Drejtues Teknik*
- *Diplomë Master i Shkencave lëshuar nga UPT në Inxhinieri e Burimeve Natyrore Profili Gjeomatikë data e lëshimit të diplomës 21.10.2011*
- *Diplomë e Nivelit të Parë në Shkencat e Tokës datë 27.04.2010 lëshuar nga UPT*
- *Licencë për vlerësimin e pasurive të paluajtshme*
- *CV*

III.3.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “c” e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “ *[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:*

III.3.4. Neni 53 pika 3 e Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji*

III.3.5. Në nenin 26 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;dhe/ose*
- b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose*
- c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushurkontratën*

III.3.6. Referuar sa më sipër KPP gjykon se operatori ekonomik “Shehu” shpk ka dorëzuar dokumentacion kontratë pune, CV si dhe listpagesa i cili vërteton se ka të punësuar në stafin e tij një Inxhinier Gjeodet të cilin e ka në punësuar në clësinë e drejtuesit teknik të kompanisë duke figuruar edhe në Licencën përkatëse të shoqërisë. Në këtë kuptim KPP gjykon se operatori ekonomik provon se disponon kapacitetet e nevojshme profesionale në përputhje me kriterin e kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimeus “Radika” shpk për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Shehu” shpk me argumentat se *“Pika 5 Operatori ekonomik duhet te kete te siguruar ne listepagesa per periudhen Janar 2018 – Prill 2018 Inxhinier hidroteknik (nje) (per inxhinierin te paraqitet diploma dhe CV); Murator (nje) (per muratorin te paraqitet deshmia e kualifikimit profesional te leshuar nga institucionet perkatese) ; Teknik Ndertimi (nje) (per teknikun e ndertimit te paraqitet deshmia e kualifikimit profesional). OE Shehu nuk vërteton se ka në listpagesa për periudhën Janar 2018-prill 2018 punonjës me profesion Murator pasi nuk ka paraqitur asnjë punonjës me dëshmi kualifikimi profesional.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.4.1. Në shtojcën 11 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3. *“Për kapacitetin teknik”, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:*

5.Operatori ekonomik duhet te kete te siguruar ne listepagesa per periudhen Janar 2018 – Prill 2018

- a) Inxhinier hidroteknik (nje) (per inxhinierin te paraqitet diploma dhe CV)*

- b) *Murator (nje) (per muratorin te paraqitet deshmia e kualifikimit profesional te leshuar nga institucionet perkatese)*
- c) *Teknik Ndertimi (nje) (per teknikun e ndertimit te paraqitet deshmia e kualifikimit profesional*

III.4.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se operatori ekonomik “Shehu” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë

- *Kontratë Individuale Pune lidhur ndërmjet Shoqërisë Shehu në cilësinë e punëdhësit dhe SH.Ç në cilësinë e punëmarrësit me profesion Murator*
- *Dëshmi Kualifikimi e Sigurimit Teknik për SH.Ç*
- *Listpagesat e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për periudhën Janar- Prill 2018 në të cilin figuron i siguruar punonjësi SH.Ç*

III.4.3. Referuar sa më sipër KPP konstaton se në kriterin e kualifikimit autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik të ketë në listpagesë për periudhën Janar -Prill 2018 një punonjës me profesion murator. Gjithashtu autoriteti kontraktor ka kërkuar që për muratorin të dorëzohet dëshmia e kualifikimi profesional. Nga shqyrtimi i dokumentacionit sa më sipër KPP vëren se operatori ekonomik Shehu shpk ka dorëzuar për muratorin listpagesat në të cilën rezulton se punonjësi SH.Ç rezulton i siguruar për periudhën e kërkuar. Gjithashtu konstatohet se është dorëzuar Dëshmia e Kualifikimit e Sigurimit Teknik për këtë punonjës.

Sa më sipër KPP gjykon se operatori ekonomik “Shehu” shpk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar në përputhje me kriterin e kualifikimit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimes “Radika” shpk nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimeus “Radika” shpk për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Shehu” shpk me argumentat se “OE Shehu nuk vërteton se ka në listpagesa për periudhën Janar 2018-Prill 2018 punonjës me profesion Teknik Ndërtimi . Tekniku i paraqitur nga Shehu është teknik arkitekt dhe nuk ka njehsuar diplomën pasi nuk është pajisur me këtë diplomë në RSH. Sipas Legjislacionit të Ministrisë së Arsimit duhet të bëhet njehsimi i diplomave të huaja”, Komisioni i prokurimit Publik vëren se,

III.5.1. Në shtojcën 11 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3. “Për kapacitetin teknik”, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

5.Operatori ekonomik duhet te kete te siguruar ne listepagesa per periudhen Janar 2018 – Prill 2018

- a) *Inxhinier hidroteknik (nje) (per inxhinierin te paraqitet diploma dhe CV)*
- b) *Murator (nje) (per muratorin te paraqitet deshmia e kualifikimit profesional te leshuar nga institucionet perkatese)*

c) Teknik Ndertimi (nje), (per teknikun e ndertimit te paraqitet deshmia e kualifikimit profesional)

III.5.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se operatori ekonomik “Shehu” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë.

- *Kontratë Individuale Pune lidhur ndërmjet Shoqërisë Shehu në cilësinë e punëdhësit dhe E.SH në cilësinë e punëmarrësit me profesion Teknik Ndërtimi dhe Topograf,*
- *CV*
- *Diplomë lëshuar në Republikën e Maqedonisë e panjehsuar nga MASH në të cilin ka kryer arsimin profesional në drejtimin ndërtimtari-gjeodezi me titull teknik i arkitekturës.*
- *Dëshmi Kualifikimi e Sigurimit Teknik nga data 13.04.2018-12.04.2019 profesioni Teknik Ndërtimi*

III.5.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “c” e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “ [...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:

III.5.4. Neni 53 pika 3 e Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji*

III.5.5. Referuar sa më sipër KPP konstaton se në kriterin e kualifikimit është kërkuar që operatori ekonomik të ketë në listpagesë për periudhën Janar -Prill 2018 një punonjës me profesion Teknik Ndërtimi. Gjithashtu autoriteti kontraktor ka kërkuar që për teknikun e Ndërtimit të dorëzohet dëshmi kualifikimi profesional. Nga shqyrtimi i dokumentacionit sa më sipër KPP vëren se operatori ekonomik Shehu shpk ka dorëzuar për Teknikun e ndërtimit listpagesat në të cilën rezulton se punonjësi E.SH rezulton i siguar për periudhën e kërkuar. Gjithashtu konstatohet se është dorëzuar Dëshmia e Kualifikimit e Sigurimit Teknik për këtë punonjës. Lidhur me diplomën e panjesuar KPP gjykon se nuk ka ndikim pasi autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar asnjë diplomë për vërtetimin e kualifikimit të Teknikut të Ndërtimit.

Sa më sipër KPP gjykon se operatori ekonomik “Shehu” shpk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar në përputhje me kriterin e kualifikimit.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues Radika shpk për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik Shehu me argumentat se “nuk ka vërtetuar se disponon

makineri (kamion) sipas specifikimeve teknike me kapacitet mbi 8 ton sasia 2 copë. Gjithashtu nuk ka vërtetuar se disponon minieskavator”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.6.1. Në shtojcën 11 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3. “Për kapacitetin teknik”, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

8. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojitet për ekzekutimin e kontratës.

Nr	LLOJI I MAKINERIVE	PRONESIA	SASIA Minimumi
13.	Kamiona me ngarkese mbajtëse mbi 8 ton	Ne pronesi ose me qera	2 cope
14.	Betoniere 0.5 m ³	Ne pronesi ose me qera	2cope
15.	Minieskavator	Ne pronesi ose me qera	1 cope
16.	Kamioncine	Ne pronesi ose me qera	1 cope
17.	Karroca dore	Ne pronesi ose me qera	5 cope
18.	Vibrator thellesie	Ne pronesi ose me qera	1 cope
19.	Depozite uji 5000l	Ne pronesi ose me qera	1 cope
20.	Kokore pune	Ne pronesi ose me qera	10 cope
21.	Fikse zjarri	Ne pronesi ose me qera	2cope
22.	Komplet I ndihmes se shpejte	Ne pronesi ose me qera	3cope
23.	Tabela paralajmeruese	Ne pronesi ose me qera	2 cope
24.	Eskavator me goma	Ne pronesi ose me qera	1 cope

9. Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese, që makineritë e mësipërme nuk do të jenë të angazhuara në kontrata të tjera por do të jenë të angazhuara vetëm për kontratën e objektit në fjalë.

(Në rast se ofertuesi është bashkim i operatoreve, çdo anëtar i këtij bashkimi duhet të paraqesë këtë dokument).

10. Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese per vendodhjen e mjeteve ne pronesi apo te marra me qira dhe autorizim per verifikimin e tyre nga AK ne cdo kohe deri ne shpalljen e fituesit. Ne rast se ofertuesi eshte bashkim i operatoreve, cdo anetar i ketij bashkimi duhet te paraqese kete dokument. Sqarim : Autoriteti Kontraktor per te vertetuar vertetesine e shtojces 10, te plotesuar nga OE, ka te drejte ne cdo kohe te verifikojte vendodhjen e percaktuar nga OE per mjetet dhe disponueshmerine e tyre. Ne rast se mjetet e deklaruar sipas shtojces 10 nuk gjenden ne vendin e percaktuar nga OE , AK ka te drejte te skualifikoje OE per mospermbushje te kriterit.

Deklarata eshte objekt verifikimi dhe kontrolli ne cdo kohe para shpalljes se fituesit dhe deri ne realizimin e plote te kontrates per subjektin qe do shpallet fitues.

13. Operatori Ekonomik të paraqesë deklaratën sipas shtojcës Nr. 9. (deklarata e makinerive)

14. Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik , siguracionin e mjetit dhe taksen.

15. Per makinerite qe nuk shenohen ne rregjistrat publike, duhet te paraqitet dokumenti qe verteton pronesine e tyre.

16. Per mjetet e marra me qera, formularit dhe dokumentave te mesiperme t'i bashkelidhen kontrata perkatese noteriale te qerases, si dhe duhet qe afati i marrjes me qira, te perfshije afatin e realizimit te kesaj kontrate ne rast te shpalljes fitues.

III.6.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se operatori ekonomik “Shehu” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë.

- Deklaratë Doganore në emër të Shehu të Minieskavator Kamatsu Bager 35 VT 1983
- Leje Qarkullimi i Mjetit me targa AA087CZ ne emër të Shehu shpk
- Certifikatë Pronësie e Mjetit
- Certifikatë e Kontrollit Teknik Kamion nga 7.5 deri 18 ton
- Policë për Sigurimin e Detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësi ndaj palëve të treta.
- Taksa Vjetore e Mjeteve
- Licencë Nr.389 datë 06.04.2018 “Për Transport Mallrash për të tretët dhe me qera brenda vendit

- Leje Qarkullimi i Mjetit me targa AA738PD,
- Certifikatë e Kontrollit Teknik Kamion nga 7.5 deri në 18 ton,
- Certifikatë e Pronësisë së Mjetit Rrugor,
- Policë për Sigurimin e Detyreshëm,
- Taksa Vjetore e Mjeteve, Licencë Nr.388 datë 06.04.2018.

III.6.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “c” e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “ [...] *Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:*

III.6.4. Neni 53 pika 3 e Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji*

III.6.5. Në nenin 26 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

- *Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*
- *a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;dhe/ose*
- *b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose*
- *c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën*

III.6.6. Referuar sa më sipër KPP gjykon se operatori ekonomik “Shehu” shpk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar në kriterin e kualifikimit sa i takon mjetit kamion dy copë me kapacitet mbi 8 ton dhe një minieskavator për të cilin ka dorëzuar deklaratën doganore përkatëse. Në këtë kuptim KPP gjykon se operatori ekonomik provon se disponon kapacitetet e nevojshme teknike në përputhje me kriterin e kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik Radika shpk nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e

rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Radika” shpk, për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për Propozime*” me Nr.REF-65953-04-29-2018 me objekt “*Rehabilitimi i Kanalit Ujitës Debrovë, Peshkopi 2018*”, me fond limit 2,500,000 leke pa TVSH, zhvilluar në datë 11.05.2018 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Dibër
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1069 Protokoli; Datë 06.06.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha

